



Komuna Deçan

MEMORANDUM I MIRËKUPTIMIT

në mes të

Komuna e Deçanit

DHE

OJQ "ABSM"- QENDRA EDUKATIVE

Ky Memorandum i Mirëkuptimit, (në tekstin e mëtuftjeshëm Memorandumi) lidhet në mes të Komuna e Deçanit dhe OJQ "ABSM"- Qendra Edukative me Qender kryesore në Zvicerr dhe me degë në Gjakovë

Qëllimi i Memorandumit

Qëllimi i këtij Memorandumi është që të ofrojmë një kornizë të bashkëpunimit dhe të koordinimit në mes të palëve të lartpërmendura në fushën zhvillimit profesional të nxënësve dhe mësimitdhënësve nga Komuna e Deçanit

Neni I

Fushëveprimtaria

- ❖ Aktivitete të përbashkëta në fushën e arsimit dhe aftësimin profesional
- ❖ Zhvillimit të kapaciteteve të mësimitdhënësve
- ❖ Projekte të përbashkëta
- ❖ Këshillimi dhe orientimi, tranzicioni në vendin e punës dhe vetëpunësimi
- ❖ Vizita studimore nga Kosova në Zvicërr dhe anasjelltas.

- ❖ Partneritete mes shkollave të Kosovës dhe të Zvicrrës

Neni II

Mënyra e bashkëpunimit

Të dy palët caktojnë nga një përfaqësues për ndjekjen dhe realizimin e bashkëpunimit që përcakton ky memorandum.

Komuna e Deçanit dhe ABSM pajtohen që për nevojat e tyre të shkëmbejnë ekspertët dhe përvojat e tyre në fushat të cilat mbulohen.

Neni III

Roli i palëve.

Palët pajtohen si më poshtë:

1. ABSM do të ofrojë shërbimet si më poshtë:
 - a) fuqizimin e kapaciteteve menaxhuese të shkollave në Komunën e Deçanit
 - b) ngritjen e kapaciteteve të mësimdhënësve në Komunën e Deçanit
 - c) Trajnime të ndryshme (Këshillim në karrierë, tranzicioni ne vendin e punës dhe vetëpunësimi, Edukimi për ndërmarrësinë, Mësimi në vendin e punës ,etj

2. Komuna e Deçanit, Drejtoria e Arsimit përmes këtij memorandumi zotohet për koordinimin e shërbimeve për nxënës apo mësimdhënës, në pikat si më poshtë:
 - a) Llojin e trajnimit
 - b) Kohën e fillimit të trajnimit
 - c) Perzgjedhjen e shkollave dhe
 - d) Përzgjedhjen e kandidatëve

Neni IV

Pjesëmarrja në trajnime

Trajnimet dhe këshillimet për nxënësit dhe mësimdhënësit nga Komuna e Deçanit do të jenë falas.

Neni V

Zotimet për të ardhmen

Komuna e Deçanit dhe OJQ "ABSM"- Qendra Edukative do të punojnë së bashku që t'i përgjigjen kërkesave të tregut të punës dhe nevojës për zhvillim profesional

Komuna e Deçanit dhe OJQ "ABSM"- Qendra Edukative bashku do të kontribuojnë në drejtim të zhvillimit, përkrahjes dhe promovimit të sektorit edukativ dhe profesional në fushën e ndërmarrësisë dhe karrierës.

Neni VI

Kohëzgjatja e Memorandumit

Ky Memorandum ka afat të pacaktuar dhe mund të plotësohet edhe me anekse tjera.

Neni VII

Zgjidhja e Memorandumit

Ky Memorandum mund të zgjidhet edhe më herët me paralajmërim paraprak prej 60 ditëve nga palët e kësaj marrëveshje.

Data: 22.04.2022 Deçan

Palët nënshkruese:

Drejtoria e Arsimit - Deçan

Bekim Vishaj, Drejtor

ABSM, Gjakovë

Skender Nikoliqi, Drejtor ekzekutiv



Drejtoria e Arsimit		13067	
07		22.4.22	

DEÇAN DEÇANE